



Në bazë të nenit 110 të Ligjit mbi Arsimit Sipëror të R.M.V., (Fleta Zyrtare e RMV nr. 82/18), nenit 68 të Statutit të Fakultetit të Shkencave Islame – Shkup dhe në bazë të Vendimit nga mbledhja e Këshillit Mësimor-Shkencor të FSHI-së të mbajtur më datë 08.04.2021 dhe Konkursit për regjistrim të studentëve në vitin akademik 2021/22, Fakulteti i Shkencave Islame – Shkup, shpall:

## KONKURS

për transferimin dhe regjistrimin e studentëve në Fakultetin e Shkencave Islame - Shkup në semestrin dimëror për vitin akademik 2021/22

**I. Transferimi do të realizohet në programet aktive studimore të Fakultetit të Shkencave Islame - Shkup:**

<b>1. Shkenat islame</b>	<b>Deridiplomik</b>
<b>2. Studime Islame</b>	<b>Deridiplomik</b>
<b>3. Studime të avancuara islame</b>	<b>Magjistraturë</b>
<b>4. Metodika e mësimdhënies në mësimbesimin fetar</b>	<b>Specializim</b>

**II. Kushtet e transferimit të studentëve në Fakultetin e Shkencave Islame - Shkup:**

1. Të drejtë transferimi nga institucionet tjera të arsimit sipëror në njësitë akademike të FSHI-së kanë të gjithë studentët që kanë regjistruar dhe të përfunduar së paku një semestër nga Universiteti (ose kanë diplomuar) i cili vjen kandidati, ndërsa detyrimet tjera i kryejnë varësisht statusit të transferimit.
2. Gjatë aplikimit, detyrimisht kandidati duhet të paraqes dëshmi për akreditimin e institucionit të arsimit të lartë, respektivisht fakultetit apo programit nga i cili transferohet ose dokumente shtesë varësisht kërkesës së komisionit për transfer;
3. Dëshmi për nostrifikimin e shkollimit të mesëm nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës të RMV-së (për shtetasit e huaj ose shkollim të mesëm jashtë vendit), apo të shkollimit sipëror (për ciklin e dytë apo specializimin).
4. Studenti mund të transferohet në fakultetin dhe programin e njëjtë studimor ose në drejtime të ngjashme të programeve studimore të FSHI-së. Ngjashmërinë e programeve studimore e përcakton komisioni për transfer i Fakultetit.

**B. Në Fakultet mund të regjistrohen edhe kandidatët që kanë kryer *shkollën e lartë ose të ngjashme* .**

1. Regjistrimi i tyre bëhet në bazë të ngjashmërisë së provimeve të dhëna dhe programeve studimore të shkollimit paraprak.

**C . Kandidatët që transferohen, regjistrohen me vetëfinancim në studime, respektivisht sipas tarifave aktuale të studimit për programet studimore në vitin akademik 2021/22.**



D . Në programet studimore ku në Konkursin për regjistrim janë përcaktuar provime pranuese (kontroll i talentit), kandidatët që aplikojnë për transferim të kredive, janë të obliguar t'i nënshtrohen provimit pranues në lëndë përkatëse.

**E. Kandidatët të cilët transferohen në semestrin e I, III, V, VII dhe IX, së pari i regjistrojnë lëndët jo të transferuara të semestrave dimëror, ndërsa pastaj lëndët e semestrit në të cilin janë transferuar, por jo më shumë se 37 ECTS së bashku, respektivisht mund të regjistrojnë vetëm 37 ECTS sipas lëndëve përkatëse.**

**F. Kandidatët të cilët transferohen në semestrin e I-rë, mund t'i regjistrojnë vetëm lëndët e semestrit I-të jo të transferuara.**

**G. Regjistrimi i lëndëve jo të transferuara bëhet në bazë të parakushteve për dëgjim.**

**III. Afatet e paraqitjes për transferimin dhe regjistrim në semestrin dimëror 2021/22:**

**REALIZIMI I KONKURSIT PËR TRANSFER DHE REGJISTRIM TË STUDENTËVE – 2021/22**

Paraqitja e kandidatëve (aplikimi në administratën e fakultetit) **01- 15.09. 2021**

Sjellja e vendimeve preliminiare për pranim të kandidatëve (Kandidati vendimin preliminar e pranon në e-mail, me të cilin ka aplikuar) **deri 16.09. 2021**

Sjellje e vendimeve përfundimtare **48 orë pas pranimit të versionit preliminar**

Regjistrimi i kandidatëve të transferuar\* **20 - 30.09.2021**

**\*KANDIDATËT TË CILËT NUK DO TA BËJNË REGJISTRIMIN E SEMESTRIT NË KOHËN E CAKTUAR, DO TA HUMBIN TË DREJTËN PËR TRANSFERIM TË ECTS KREDIVE**

**IV . Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:**

- **Fletëparaqitja** për aplikim (e cila mund të merret në sportelet e Shërbimit studentor të FSHI-së),
- **Certifikata origjinale e notave dhe indexi** nga Universiteti amë;
- **Vërtetim për statusin e fundit të studentit;**
- **Dëshmi për akreditimin e njësisë akademike (shtetasit e huaj);**
- **CV**
- **Dëftesat origjinale** nga shkollimi i mesëm (ose të verifikuara në noter) dhe **Diplomën e shkollës** së mesme të kryer;
- **Certifikatën e lindjes** dhe dëshmi për **nënshtetësi** (certifikatë ose aktvendim);

**Vërtetim për pagesën:**

- a) **3.000 denarë:** në studime **Deridiplomike**, në emër të taksave administrative
- b) **5.000 denarë:** në studime **Pasdiplomike**, në emër të taksave administrative



Kandidatët të cilët janë të pranuar (pas shpalljes/dhënies së Vendimit përfundimtar), në afatin e caktuar duhet të realizojnë regjistrimin e studimeve, në të kundërtën vendimi i transferimit do të shpallet i pavlefshëm.

**Gjatë regjistrimit duhet të dorëzojnë:**

1. Fletëparaqitje për regjistrim (fletëparaqitjet merren në shërbimin për çështje studentore të Fakultetit)
2. Aktvendim ose dëshmi për çregjistrimin e studimeve nga fakulteti i cili transferohet (varësisht mënyrës së studimeve);
3. Tri fotografi ( 1- fotografi 6 x 9 dhe 2 – 4 x 5 c.m.)
4. Vërtetim për pagesën e mjeteve:

- **500 dinarë**, në emër të dhënies së Indexit.
- **400 dinarë** pagesa për fletoret e provimit.
- **300 dinarë** pagesa për Revistën mujore Hëna e Re.
- **100 dinarë** në emër të Kuvendit studentorë në FSHI.
- Pagesë e mjeteve për semestrin e parë, varësisht nga statusi i studimit.

Të gjitha pagesat e lartpërmendura do të kryhen në xhiro-llogarinë e Fakultetit, në këtë mënyrë:

- ❖ Në emri i marrësit ( **назив на примачот** ) – Fakulteti i Shkencave Islame - Shkup,
- ❖ Në „banka e marrësit” ( **банка на примач** ) – Halkbank AD Shkup,
- ❖ Në “llogaria” ( **сметка** ) – 270070852730133,
- ❖ Në “shuma” ( **износ** )– shuma e mjeteve financiare që duhet të paguhen,
- ❖ Në rubrikën qëllimi i realizimit të pagesës ( **цел на дознака** ) – qëllimi i pagesës (semestri etj.)

Të gjithë kandidatët dokumentet e tyre për aplikim dhe regjistrim duhet t’i dorëzojnë në shërbimet studentore të Fakultetit të Shkencave Islame - Shkup

Konkursi do të shpallet në faqen e internetit: <http://www.fshi.edu.mk>,

**Shkup, prill, 2021**

**Fakulteti i Shkencave Islame - Shkup**